

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: N.N.T. VEHA me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **26.05.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.N.T. VEHA** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi i përrrenjve në Komunën e Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-1592-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-024-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.N.T. VEHA** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi i përrrenjve në Komunën e Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-1592-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-024-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.05.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-25-1592-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-024-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **N.N.T. VEHA** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi i përrrenjve në Komunën e Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-25-1592-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-024-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.05.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.05.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II.

Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional:

2.3. Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose master, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e **Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose master**, keni prezantuar: **Bardhyl Kryeziu**;


Inxhinieri në fjalë nuk është i pranueshëm, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje mes dëshmive të prezantuara, pasi që te CV-ja e Inxhinieri në fjalë kemi një nënshkrim tjetër, ndërsa te kontrata e prezantuar me këtë Inxhinier, kemi një nënshkrim tjetër;

Kontrata e Nënshkruar nga Inxhinieri:

ING. Bardhyl Kryeziu

CV-ja e Nënshkruar nga Inxhinieri:

Nënshkrimi:



Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së.

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 227,000.00 Euro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 4: Lista e punëve të realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi

(i) kur punët janë bërë për një Autoritet Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata/raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar,

(ii) kur punët janë bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të prezantuar, ne baze të dëshmive të dorëzuara nga juaj, vlera që Autoriteti Kontraktues ka konstatuar si të pranueshme referenca të dorëzuara janë:

Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqe bujqësore: 59,751.90 Euro;

Ndërtimi i infrastrukturës Bujqësore: 67,150.00 €, në total të pranuar janë: 126,901.90 €, gjë që nuk përmbushë kërkesat e AK-se pasi që vlera e kërkuar është vlera min. 227,000.00 Euro;

Andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së**

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 6: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 9 të Dosjes së Tenderit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 6: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.).

Vëmendje!

Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate të nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jete origjinale në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar *që Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 9 të Dosjes së Tenderit*

2. Kamion (Kiper maksimum 4ton pesha bartëse) – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje është: *Pesha Maksimale e ngarkesës së lejuar: 7,490.00 kg;*

Andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform LPP-së;**

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Gjetjet në dosjen tenderuese e OE të propozuar për kontratë:

Pretendimi 1

Sipas kërkesës si në FDT Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 20 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 20 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë listë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik;

Grupi i Operatorëve Ekonomik GOE i propozuar për kontratë për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur “LISTA E PUENSUARVE” (OE1) dhe “LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË” (OE2) ku asnjëra nga listat nuk e plotëson këtë kriter sipas kërkesës. OE GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K. (OE1) ka ofruar “LISTA E PUENSUARVE” për plotësim të këtij kriteri ku nuk janë të paraqitura “Mosha e Punëtorit”, “Eksperiencia vite” dhe “pozicioni në kompani”. Lista nuk posedon as datë dhe as numër ose emër prokurimi dhe nuk dihet se kur është përpiluar kjo listë. OE N.P.T. "Bamirs" (OE2) ka ofruar “LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË” e shkarkuar nga Sistemi elektronik i ATK-së me datë 16.05.2024. Kjo listë as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat e AK sipas përshkrimit. Në këtë listë nuk figurojnë: mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Ky kriter nuk është plotësuar nga GOE i propozuar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur **me pretendimin tuaj ankimor**, për Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë **është i pabazuar**

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit

Grup i Operatorëve Ekonomik të propozuar për Kontratë, ka ofruar bashkë me ofertën e tij edhe **Listë të Numrit të punëtorëve sipas Kërkesës Nr. 1 të Kapacitetit Teknik dhe Professional**

*Lista e Numrit të Punëtorëve të prezantuar nga Operatori Ekonomik: GZIMI-GARTEN-UND
LANDSCHAFTSBAU SH.P.K.*

LISTA E PUENSUARVE

"GZIMI-GARTEN UND LANDSCHAFTSBAU" SHPK

Gzimi Garten -Und Landesch			Rahovec,R.Kosoves			Rahovec	
N.Fiskal: 810733106						NRB: 70555352	
Emri	Mbiemri	IDPersonale	Nenshkrimi	Dt Lindjes	Vendi I lindjes	Adresa	Titulli
ADONIS	TARA	1002482939		17.11.1982	Rahovec	Bekim Sylka	Menager Projektit
BAKI	SHALA	1003677911	<i>Baki Shala</i>	25.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor
BLENDAR	FERATI	1248079742	<i>Blender Ferati</i>	22.06.1985	Rahovec		Puntore
PETRIT	VELIU	1003674912	<i>Petr Veliu</i>	11.03.1976	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Menager
LIRIDON	PALLQA	2170107627	<i>Liridon Pallqa</i>	06.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor
LUAN	HOTI	1007636306	<i>Luan Hoti</i>	25.09.1972	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
ALI	SHTAVICA	1248096558	<i>Ali Shtavica</i>	15.08.1999	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
HAMIDE	VELIU	1249341424	<i>Hamid Veliu</i>	04.03.2002	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntore
Sadik	Cana	1002403613	<i>Sadik Cane</i>	24.07.1979	Rahovec	Uck-se	Puntor
SABINA	DURGUTI	1170687139	<i>Sabina Durguti</i>	13.04.1986	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntore
BENIAMIN	REXHA	1243902491	<i>Beniamin Rexha</i>	15.09.1995	Rahovec	Deshmoret e Zatriqit	Puntor
ELFRID	SHTAVICA	1171454600	<i>Elfrid Shtavica</i>	25.09.1984	Rahovec	Xhelal Hajda	Puntor

GZIMI-GARTEN UND LANDSCHAFTSBAU SHPK



Lidhur me Pretendimin tuaj Ankimor se Operatori Ekonomik: GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K. tek Lista e Punëtorëve nuk ka paraqitur “*Mosha e Punëtorit*”, “*Pozicioni në Kompani*”

Ne Listën e Punëtorëve të prezantuar si më lartë është cekur, **Dt. Lindjes** dhe **Titulli** d.m.th. Pozicioni në Kompani.

Ndërsa Lista e Punëtorëve të prezantuar nga Operatori Ekonomik: N.P.T. "Bamirs", përpos Listës së Punëtorëve të prezantuar nga Sistemi elektronik i ATK-së,

Ka prezantuar dhe Listën e Punëtorëve sipas Kërkesës Nr. 1 të Kapacitetit Teknik dhe Professional

Gjeni te bashkangjitur:



Zekë Bajraktari nr.578
Nui: 810633398
Suharekë 23000
Republika e Kosovës
E-mail: ntp_bamirs@yahoo.com

Zekë Bajraktari no.578
Nui: 810633398
Suharekë 23000
Republic of Kosovo
E-mail: ntp_bamirs@yahoo.com

LISTA E STAFIT UDHËHEQËS

Lista e Punëtorëve						
Nr.	Emri dhe mbizotëri	Moshë e Punëtorit	Profesioni	Ekspieranca (vite)	Posta në kompani	Nënkohjet e punës
1	BEKIM KRASNIQI	50 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Ndërtimit	15	Inzhinier Konstruktiv	<i>[Signature]</i>
2	VALON ELSHANI	38 vjeç	Arkitekt	11	Arkitekt	<i>[Signature]</i>
3	MUSELI SHALA	59 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Ndërtimit	14	Inzhinier i Hidroteknikës	<i>[Signature]</i>
4	VALON GASHI	43 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Elektroteknikës	14	Inzhinier i Elektroteknikës	<i>[Signature]</i>
5	RUZHDI SHTERRBANI	60 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Makinerisë	19	Inzhinier Termoelektrik	<i>[Signature]</i>
6	ADRIATIK FETIU	37 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Ndërtimit	6	Inzhinier i Gjeodezisë	<i>[Signature]</i>
7	ARMEND SADIKU	40 vjeç	Master i Arteve në Menaxhimin e Emergjencave	6	Menaxhim Emergjencave	<i>[Signature]</i>
8	KORAB BAJRAKTARI	21 vjeç	Inzhinier i Ndërtimit	3	Teknik i Ndërtimit Saldues i Certifikuar ISO 9606-1	<i>[Signature]</i>
9	PASHTRIK BAJRAKTARI	21 vjeç	Bachelor i Gjeodezisë	3	Teknik i Ndërtimit Saldues i Certifikuar ISO 9606-2	<i>[Signature]</i>
10	AGIM TROLLI	42 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	23	Punëtor Teknik Armirues	<i>[Signature]</i>
11	ZEQIR TROLLI	62 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	43	Punëtor Teknik Armirues	<i>[Signature]</i>
12	BEXHET KUSHAJ	53 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	34	Punëtor Teknik Murator	<i>[Signature]</i>
13	AVDULLAH KUSHAJ	50 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	31	Punëtor Teknik Murator	<i>[Signature]</i>
14	GAZMEND KABASHI	42 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	23	Punëtor Teknik Latues	<i>[Signature]</i>
15	SHENSI ÇERIMAJ	40 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	18	Punëtor Teknik Latues	<i>[Signature]</i>
16	IDEAL KUSHAJ	21 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	2	Punëtor Teknik Fassader/Gipsier	<i>[Signature]</i>
17	GAZMEND BAJRAKTARI	43 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	22	Elektroinstalues	<i>[Signature]</i>
18	EGZON SHUKOLLI	28 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	9	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	<i>[Signature]</i>
19	HAXHI BASHA	52 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	28	Punëtor Teknik Hidroizolues	<i>[Signature]</i>
20	ARBINOR BAJRAKTARI	45 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	21	Punëtor Teknik në Ndërtimin e Kulmave	<i>[Signature]</i>
21	DRITON VELIU	47 vjeç	Punëtor Teknik - Ndërtimtar	23	Mani pulues i Makinës Ndërtimore	<i>[Signature]</i>
22	ASIM MORINA	37 vjeç	Teknik i Makinerisë	13	Punëtor Teknik Kranist	<i>[Signature]</i>
23	ELSA BAJRAKTARI	24 vjeç	Bachelor Shkencave në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësiror	2	Specialiste në Mbrojtjen kundër Zjarrit	<i>[Signature]</i>
24	ORNELA BAJRAKTARI	22 vjeç	Bachelor i Arteve Aplikative Dizajn Grafik	2	Specialiste e CCTV	<i>[Signature]</i>
25	HYMETE BAJRAKTARI	47 vjeç	Master i Arteve në Menaxhimin Sektorial	9	Integruar e Komandës së Partit	<i>[Signature]</i>
26	GËZIM BAJRAKTARI	47 vjeç	Inzhinier i Diplomuar i Makinerisë	17	Inzhinier Konstruktiv dhe Dizajner	<i>[Signature]</i>

I certifikuar me EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, BS ISO 9001:2012, ISO/IEC 27001:2013, ISO 3834-2/2005, BS PAS 55/2013, ISO 28001:2007, ISO 45001:2018, SA 8000:2014



Zekë Bajraktari nr.578
Nui: 810633398
Suharekë 23000
Republika e Kosovës
E-mail: ntp_bamirs@yahoo.com

Zekë Bajraktari no.578
Nui: 810633398
Suharekë 23000
Republic of Kosovo
E-mail: ntp_bamirs@yahoo.com

LISTA E STAFIT UDHËHEQËS

Lista e Punëtorëve						
Nr.	Emri dhe mbizotëri	Moshë e Punëtorit	Profesioni	Ekspieranca (vite)	Posta në kompani	Nënkohjet e punës
27	Ymer Kushaj	38	Bachelor i Ekonomisë	14	Ekonomistë i diplomuar	<i>[Signature]</i>
28	Atnan Thaqi	44	Teknik i makinerisë	18	Teknik i makinerisë	<i>[Signature]</i>
29	Sadat bajraktari	58	Teknik i makinerisë	24	Teknik i makinerisë	<i>[Signature]</i>
30	Arber Ukaj	42	Teknik i makinerisë	12	Teknik i makinerisë	<i>[Signature]</i>
31	Vllaznim Ilytyqi	56	Teknik i Ndërtimtarisë	20	Teknik i Ndërtimtarisë	<i>[Signature]</i>
32	Shqip Kushaj	40	Bachelor i Ekonomisë	17	Ekonomistë i diplomuar	<i>[Signature]</i>

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi 2

Sipas kërkesës si në FDT Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.3. Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose master, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit; Dëshmia 2: • Diplomat përkatëse – Kopje; • Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt; • CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); • Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; • Licenca kopje e

3/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Gjeodetit, për pikën 2.3; • Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëltur nga Operatori Ekonomik, për pikën 2.1 & 2.2. GOE i propozuar për kontratë ka prezantuar Gjeodet Shaban Hoti me Diplomë Master Profesional i diplomuar me datë 07.05.2019. Gjeodeti i propozuar ka më pak se 6 vite pas diplomimit nga data e Njoftimit për Kontratë. Ky kriter nuk është plotësuar nga GOE i propozuar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Grupin e Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit

Grup i Operatorëve Ekonomik të propozuar për Kontratë, ka ofruar bashkë me ofertën e tij, Inxhinier të Diplomuar të Gjeodezisë – Master, **Shaban Hoti, Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose master, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit.**

Inxhinieri në CV e prezantuar ka përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit, po ashtu Diplomë e Studimeve Bachelor e prezantuar, ceket se Inxhinieri Studimet i mbaroi më 21 shkurt 2017, ndërsa data e mbrojtjes së diplomës Master Profesional, ceket se data e mbrojtjes së diplomës është: 02.04.2019, ku Inxhinieri në fjalë ka përvojë pune nga data e diplomimit, min. 8 vite;

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Pretendimet në arsyet e eliminimit të kompanisë sonë:

Pretendimi 3

Arsya e eliminimit 1 sipas AK: "Në ofertën e juaj të dorëzuar Inxhinier i Gjeodezisë ose master, keni prezantuar: Bardhyl Kryeziu. Inxhinieri në fjalë nuk është i pranueshëm, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje mes dëshmive të prezantuara me këtë inxhinier, kemi një nënshkrim tjetër;

Në lidhje me këtë pretendim ju sqaroj se: Inxhinier i Gjeodezisë Bardhyl Kryeziu ka firmosur të dy këto dokumente dhe firma është e njëjtë.

Në lidhje me vërtetësinë e firmës ju si AK keni mundur ta kontaktoni ing Bardhyl Kryeziu në numrin e telefonit si në CV. Pretendimi i juaj në këtë arsye të eliminimit nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Me *Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, kemi cekur:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose master, keni prezantuar: **Bardhyl Kryeziu**;

Inxhinieri në fjalë nuk është i pranueshëm, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje mes dëshmive të prezantuara, pasi që te CV-ja e Inxhinieri në fjalë kemi një nënshkrim tjetër, ndërsa te kontrata e prezantuar me këtë Inxhinier, kemi një nënshkrim tjetër;


Kontrata e Nënshkruar nga Inxhinieri:

ING. Bardhyl Kryeziu



CV-ja e Nënshkruar nga Inxhinieri:

Nënshkrimi:




Mospërputhje mes dëshmive të prezantuara (nënshkrimit), kemi edhe tek Inxhinierë tjerë të prezantuar në ofertën tuja, siç janë:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 8 vite pas diplomimit, keni prezantuar: **Halil Bytyqi**;

Kontrata e Nënshkruar nga Inxhinieri:

ING. Halil Bytyqi



CV-ja e Nënshkruar nga Inxhinieri:




Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën: **Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Hidroteknik, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit**, keni prezantuar: **Blerim Kuçi**;

Kontrata e Nënshkruar nga Inxhinieri:

CV-ja e Nënshkruar nga Inxhinieri:

ING. BLERIM KUÇI



tek: +381 (0)

Pra për të gjithë stafin Profesional te prezantuar kemi **Mospërputhje mes dëshmime të prezantuara (nënshkrimit)** nga Inxhinierët.

Pretendimi juaj në këtë pikë **është i pabazuara**

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Pretendimi 4

Arsya e elimimit 2 sipas AK: “Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 227,000.00 Euro;”. Në ofertën e juaj të prezantuar, në bazë të dëshmime të dorëzuara nga ana e juaj, vlera që AK ka konsideruar si të pranueshme referencat e dorëzuara janë: Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqe bujqësore: 59,751.90 euro; Ndërtimi i infrastrukturës Bujqësore: 67,150.00 euro, në total të pranuar janë: 126,901.90 euro që nuk e përmbush kërkesat e AK-së pasi që vlera e kërkuar është vlera min. 227,000.00 euro.

Në lidhje me këtë pretendim ju sqaroj se: Në listë është dhe kontrata me Certifikatë të Pranimit: Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit: 102,597.80 euro.

Bazuar në OPINIONIN e KRPP-së nr. 11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme”, megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, **është i pabazuar**

Me **Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, kemi cekur:

Në ofertën e juaj të prezantuar, ne baze te dëshmime te dorëzuara nga juaj, vlera qe Autoriteti Kontraktues ka konstatuar si te pranueshme referenca te dorëzuara janë:

Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqe bujqësore: 59,751.90 Euro;

Ndërtimi i infrastrukturës Bujqësore: 67,150.00 €, në total të pranuar janë: 126,901.90 €, gjë që nuk përmbushë kërkesat e AK-se pasi që vlera e kërkuar është vlera min. 227,000.00 Euro;

Andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së**

Në lidhje me **Kërkesës tuaj për Rishqyrtim**, keni cekur edhe OPINIONIN e KRPP-së lidhur me

Referencat të natyrës së ngjashme, ku ndër të tjera ne ketë Opinion ceket: *Në kë rast si orientim i mirë për*

përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Duke u bazuar në Opinionin të cekur më lartë, Aktiviteti i Prokurimit është në kodin e **shërbimeve (2)**, ndërsa Referencat e tjera të prezantuara nga ana juaj janë me Kodin e **Punëve (5)**, ku sipas këtij Opinioni Referenca: **Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit** është e pa pranueshme për ne si AK

ANEKS 8 Lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit
(duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë)
(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë)

Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit të Blerësit
1	Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore (Kanal i Hapur), Samadraxhë, Reshtan-Studençan	29.06.2022	11.01.2023	59,751.90	Komuna Suhareke	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029271026
2	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pyltari	20.06.2022	11.01.2023	67,150.00	Komuna Suhareke	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029271026
3	Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit	10.06.2024	04.10.2024	102,597.80	Komuna Suhareke	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029271026

Bashkëngjit: certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankesë dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi i rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një ofertë e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____



Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

Pretendimi 5

Arsya e eliminit 3 sipas AK: “Kërkesa 6: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;” me sqarim: Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, paisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 9 të Dosjes se Tenderit: 2. Kamion (Kiper maksimum 4 ton pesha bartëse) – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë paisje është: Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar: 7,490.00 kg;

Në lidhje me këtë pretendim ju sqaroj se: Pesha e Paisjes dhe Pesha Maksimale e ngarkesës së lejuar në këto dy rubrika janë ngatërruar njëra me tjetrën nga Qendra e Regjistrimit. Është e palogjikshme që Pesha Totale të jetë më e vogël se sa Pesha Maksimale e Ngarkesës së Lejuar. Pesha e kamionit është 4,800.00 kg, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është: 2,690.00 kg ndërsa pesha totale është 7,490.00. Kjo mund të vërtetohet shumë lehtë edhe në Librezat tjera të qarkullimit apo në Qendrën e Regjistrimit.

Pretendimi i juaj në këtë arsye të eliminimit nuk qëndron.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Me *Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, kemi cekur:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe professional, është kërkuar që *Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit*

2. Kamion (Kiper maksimum 4ton pesha bartëse) – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje është: Pesha Maksimale e ngarkesës së lejuar: 7,490.00 kg;

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së;

Libreza e prezantuar nga ana juaj, tek F1 Pesha Maksima e ngarkesës se lejuar është: 7490

A	Nomer i regjistrimit; Licj e personave; Registration number;	01-947-QL	D3	Përshkrimet komerciale; Commercial description;	TGL 8 180 4X2 BL	P	Motort; Motor;	
I	Data e regjistrimit; Licj e personave; Date of registration;	03.03.2022	E	Nomeri identifikues i shiritit; Identification number of the vehicle;	WMAN13ZZ87Y177528	P1	Kapaciteti (në cm3); Capacity (in cm3);	4580
C	Të dhënat personale; Personal data;		S	Viti i prodhimit; Year of production;	2008	P2	Fuqia maksimale neto (në kW); Maximum net power (in kW);	132,00
C.2	Problemi i mjeteve; Vehicle problem;		S	Kapaciteti i ulësve; Seating capacity;	2	P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjisë; Type of fuel or power source;	Dizel
C.2.1	Mbiktheqës ose shtet i huaj; Owner or business;	ABC CONSTRUCTION SH.PK.	S.1	Nomeri i ulësve; Number of seats;		R	Shteti i pajisjes; Country of the vehicle;	BL - E GJELBER/LLOGO
C.2.2	Emri; Name;		S.2	Nomeri i vendëve për qëndrim; Number of standing places;		2A	Ndërtesa; Construction;	Kamion Kiper me 2 dyer
C.2.3	Adresa; Address;	Luan Haradinaj Str 1 Hy.1 nr.4 Prishtine	Q	Raporti fuqi/peshë (në kW/kg); Power/Weight ratio (in kW/kg);			Shënime; Remarks;	
B	Data e regjistrimit të partit; Date of first registration;	02.11.2008	F	Peshë; Mass;	2690			
D	Automjeti; Vehicle;		F1	Peshë e ndërtimit të lejuar; Maximum permissible laden mass;	7490			
D.1	Marka; Make;	MAN	G	Peshë e ndërtimit; Mass of the vehicle;	4800			
D.2	Tipi; Type;	N13	K	Homologimi; Type of approval;				

Libreza është e dukshëm pastër, dhe neve si AK nuk na lejohej të kërkojmë sqarime nga Qendra e Regjistrimit se a ka bere gabim teknik apo jo Qendra e Regjistrimit? Sipas pretendimit tuaj Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>